



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr. 192/1 Prot

Elbasan, më 6. 2.2025

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT TË BASHKISË LIBRAZHD

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.01, datë 31.01.2025 "Mbi kriteret e përdorimit të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% për vitin 2025", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI
Ali MYSLIU

192
04.02.2025
SEKRETARIA
DREJTORIA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E SHQIPËRISË



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHË
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Datë.04.02.2025

Nr.668 prot

Nr.1 dt.31.01.2025

**Mbi kriteret e përdorimit të fondit të kushtëzuar për Bllok Ndihmën
Ekonomike deri në 6% për vitin 2025**

Mbështetur në ligjin 139/2015 për "Vetqeverisjen Vendore", Ligji 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar me Ligjin nr 137/2020, bazuar në nenin 21 të ligjin 57 datë 18.07.2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", ku citohet shprehimisht: **Këshilli bashkiak miraton kriteret për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese, të cilat nuk janë shpallur përfutuese nga sistemi i pikëzimit, bazuar në vlerësimin social-ekonomik të kryer nga administratori shoqëror.** Me propozim të strukturave përgjegjëse për shërbimet sociale, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 31.01.2025 dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd:

VENDOSI:

1. Miratimin e kriterëve specifike për familjet që do të përfitojnë Ndihmë Ekonomike me 6% e fondeve të kushtëzuara të Bllok-Ndihmës për vitin 2025.

1.1 Përfshihen në skemën e 6% familjet të cilat janë shpallur me pikë të pamjaftueshme nga sistemi NE dhe mbartin problematikat e mëposhtme social-ekonomike.

- Të jenë familje me kryefamiljare Gra dhe në gjendje të dobët ekonomike.
- Të jenë familje që kanë në përbërjen e tyre Persona me Aftësi të kufizuara apo Invalidë Pune
- Të jenë familje ekstremisht të varfëra qoftë edhe kur kanë një automjet të regjistruar por nuk e kanë në përdorim dhe nuk e kanë çregjistruar në Drejtorinë Rajonale të automjeteve për arsye ekonomike.
- Të jenë familje me fëmijë jetim ose në kujdestari të ketyre fëmijëve.
- Të jenë familje me probleme të ndryshme Sociale, dhunë në familje, proces divorci etj.
- Familje që kanë pësuar fatkeqësi natyrore.

2. Për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike duhet të jetë kryer paraprakisht vlersimi social ekonomik në familje nga administrator shoqëror sipas formularit tip të verifikimit dhe që ruhet në dosjen e dokumentave të aplikantit pranë njësisë vendore dhe që i bashkëngjitet Pr/Vendimit të ardhur nga Njësitë Administrative.

3. Ndjek zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10(dhjetë) ditë pas shpalljes.

SEKRETAR I KËSHILLIT
Elson MALLUTA

KRYETARI I KËSHILLIT
Mitat BIÇAKU